



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME E AGROBIZNESIT "IRAKLI TEROVA" KORÇË

Nr 193 prot

Korçë më 13.12.2022

Lënda: Njoftim për vend të lirë

Drejtuar : Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Tiranë

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Ofruesi publik i AFP-së. Shkolla e mesme e Agrobiznesit "IRAKLI TEROVA " Korçë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin/pozicionet:

MESUES I LENDEVE të Teorisë VETERINARE

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë të punës si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a. të ketë diplomë Përkatese niveli Master profesional në fushën e Veterinarisë ose të barazvlefshëm me të njëjten fushë me njerin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP.
- b. të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c. të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën;
- e. librezën e punës;
- f. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g. ertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;

3. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

4. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda dates

27.12.2022

DREJTORI I SHKOLLËS

(ADRIAN SHEREMET)

